

SUBORDINATE OBJECT CLAUSES WITH NON-FINITE VERB FORMS IN ENGLISH AND ALBANIAN

Hatixhe Sejdini-Leka

University of Tirana, Faculty of Foreign Languages, English Department

E-mail: gsejdini@yahoo.com

Received: 2012-10-01 Accepted: 2012-10-07 Published: 2012-11-01

Abstract

In this paper we aim to provide a context for understanding some practical syntactical issues, hoping that we will somehow help English teaching in our classrooms. Sentence analysis brings about the growth of students' knowledge of syntactical issues and enables them to compare English sentence structures with the structures of their mother tongue, Albanian and those of other languages as well. We try to identify and analyze similarities and differences of the complex sentences with non-finite object clauses in English with those of the Albanian language. In this paper there will be presented various examples from different sources. These sentences will be compared so that their morphological and syntactical characteristics can be identified.

Keywords: Complex Sentence, Object Clause, Verb, Non-finite verb form, subordinator.

Hyrje

Fjalitë e nënrenditura kundrinore me formë të pashtjelluar foljore

Në gjuhën angleze gjatë analizës që i bëhet fjalive nga gjuhëtarë të ndryshëm njihen apo identifikohen edhe ato tipe fjalish të cilat në përmbajtjen e tyre kanë një formë të pashtjelluar foljore¹⁷. Këto ndryshe quhen edhe fjali pa folje (verbless clauses) por që pavarësisht këtij fakti analizohen si fjali apo pjesë fjali në rast se janë pjesë e një strukture të përbërë apo komplekse, pasi ekziston një lidhje kallëzuesore mes gjymtyrëve të tjera të këtyre fjalive². Në gjuhën angleze hasim disa fjali të nënrenditura, ndër të cilat edhe ato kundrinore, të cilat kanë si folje kallëzues një formë të pashtjelluar. Disa nga këto raste po i paraqesim më poshtë.

1. Folja kallëzues e shprehur me “infinitive” (to +rrënjën e foljes)

Shembuj [1]

- a. Luckily for Victoria Beckham Tom chose **not to come** to the Madrid Hospital where she was recovering after giving birth to the 3rd son. “Ok” March 8.2005 (fq 12)
(Për fatin e mirë të Victoria Beckamit, Tom vendosi **të mos vinte** në spitalin e Madridit ku ajo merrte veten pas lindjes së djalit të 3^{te}).
- b. I try always **to hope** but sometimes I can not. “A Farewell to Arms” (fq 71)
(Përpiqem gjithmonë **të kem** shpresë por ndonjëherë nuk mundem.)
- c. I think you wanted **to satisfy** yourself. “Death in Holy Orders” (fq 14)
(Besoj se doje **të kënaqeshe** vetë.)
- d. I don't want **to be** blind. “Angel Face” (fq 20)

¹⁷ 1. Randolph Quirk, Sidney Greenbaum, Geoffrey Leech, Jan Svartvik, “A Comprehensive Grammar of the English language”, Longman, 1985. 2. Randolph Quirk, Sidney Greenbaum, Geoffrey Leech, Jan Svartrik, “A Grammar of Contemporary English”, Longman, 1985 / 1990.

Nuk dua *të jem* i verbër

Në shembujt e përmendur më lart kryefjala është e përbashkët si për fjalinë kryesore dhe për atë të varur kundrinore. Fjalja kryesore karakterizohet nga një formë foljore e mënyrës dëftore si në gjuhën angleze edhe në gjuhën shqipe. Këtu do të donim të theksonim se folja kallëzues e fjalisë së varur mund të vendoset në secilën prej kohëve të mënyrës lidhore në fjalitë gjegjëse të gjuhës shqipe. Po të vërejmë me kujdes shembujt shohim se në shqipe, format foljore tipike janë në një formë të shtjelluar (të gjitha këto kohë të mënyrës lidhore): respektivisht [1a] koha e pakryer, [1b] koha e kryer, [1c] koha e pakryer, [1d] koha e tashme, ndërsa në anglishte ato janë në një formë të pashtjelluar foljore, në “infinitive”. Më poshtë po paraqesim disa shembuj të tjerë që ilustrojnë te njejtin mendim.

Paris tried *to forget* the woes as she partied in her very own night club in Florida.

(Paris u përpoq *të harronte* dhimbjet e saj teksa festonte në klubin e saj të natës në Florida.)

“Ok” March 8. 2005 (fq 16)

I really want *to represent* this country.

“Ok” March 8.2005 (fq 132)

(Vërtet dua *të përfaqësoj* këtë vend.)

I do want *to win* but I need everybody to vote for me.

“Ok” March 8.2005 (fq 132)

(Unë vërtet dua *të fitoj* por kam nevojë që gjithsecili prej jush të votojë për mua.)

You must be surprised *to see* me.

(Besoj se habitesh që *po më takon*).

Në fjalinë e fundit të këtij grupi shembujsh folja kallëzues në fjalinë e nënrenditur kundrinore është në kohën e tashme të mënyrës dëftore e jo atë të lidhore. Kjo folje në shqipe mund të haset edhe në kohë të tjera të kësaj mënyre si për shembull në kohën e pakryer, kohën e kryer të thjeshtë e kohën e ardhme. (*Besoj se habitesh që po më takon / më takove / do të më takoje.*)

2.Një rast tjetër i fjalive të përbëra me pjesë të varur kundrinore është kur fjalja e nënrenditur ka një folje në infinitiv dhe një kryefjalë të sajën, të ndryshme nga ajo e fjalisë kryesore.

Shembuj [2]

He wants you *to go* and pick her up.

“Angel Face” (fq 21)

(Ai do që *të shkosh ta marrësh ti.*)

(Ai do që *ti të shkosh ta marrësh.*)

Përsëri folja gjegjëse në shqipe është një folje në mënyrën lidhore, dhe fjalja e nënrenditur ka një kryefjalë të ndryshme në të dyja gjuhët. Ai që ndryshon, është rendi i kryefjalës në fjalinë e nënrenditur. Në anglishte ajo vjen menjëherë pas foljes kallëzues së fjalisë kryesore, ndërsa në shqipe ajo vendoset në fund të fjalisë ose menjëherë pas lidhëzës në raste theksimi.

3.Folja në fjalinë e nënrenditur ndodh të jetë në infinitiv edhe kur fjalja kryesore lidhet me atë të nënrenditur me anën e një fjale pyetëse qoftë kjo ndajfolje a përemër.

Shembuj [3]

I knew *where to begin*.

“Death in Holy Orders” (fq 3)

(Unë dija *se nga t’ia filloja.*)

Vol I, Nr.2, 2012.

ISSN 1857-8179 (Paper) ISSN 1857-8187 (Online)

Me këtë shembull vazhdojmë të ilustrojmë dhe përforcojmë faktin që infinitivi në anglishte përkon me një folje në mënyrën lidhore në shqipe.

4.Një tjetër strukturë e cila ka në përbërjen e saj një formë të pashtjelluar në gjuhën angleze është fjalia e nënrenditur kundrinore me një folje kallëzues në “xherund”, (ose përcjellore) (*verb + - ing*).

Shembuj [4]

a. I remember *thinking* then that it was unkind of the other two not to wait for him.

(Mbah mend se atë çast *mendova* që ishte e pakëndshme që dy të tjerët nuk e pritën atë.)

“Death in Holy Orders” (fq 9)

b. You’ll be quicker in the car. I don’t mind *waiting*.

“Death in Holy Orders” (fq 9)

(Do të shkosh më shpejt me makinë. Unë nuk e kam problem *të pres*.)

c. Raphael himself had insisted on *training* at St Anselm’s.

1. (Vetë Rafaeli kishte këmbëngulur *të studionte* në Shën Anselm.)

2. (Vetë Rafaeli kishte këmbëngulur *për trainimin* e tij në Shën Anselm.)

“Death in Holy Orders” (fq 40)

Në shembujt e dhënë folja kallëzues e fjalisë kundrinore e shprehur me formën e pashtjelluar të xherundit në gjuhën angleze, “- *ing participle*”, realizohet me forma të tjera foljore në shqipe apo edhe me gjymtyrë të shprehura me pjesë të tjera të ligjëratës. Le t’i shqyrtojmë me radhë këto raste. Në fjalinë [4a] folja kallëzues e fjalisë së nënrenditur është “*thinkig*”, një formë e pashtjelluar në gjuhën angleze, e cila në fjalinë e gjuhës shqipe përkon me foljen kallëzues “*mendova*”, një formë foljore e shtjelluar e mënyrës dëftore (koha e kryer e thjeshtë,veta e parë, nr njejës). Edhe në shembujt [4b] dhe [4c] foljet kallëzues të shprehura me formën e pashtjelluar të xherundit në anglishte përkojnë me një folje kallëzues të shtjelluar në shqipe e përkatësisht me një formë foljore të mënyrës lidhore:

anglisht	shqip
fjalia [4b] <i>waiting</i>	të pres (mënyra lidhore, koha e tashme, veta e I, njejës)
fjalia [4c] <i>training</i>	të studionte (mënyra lidhore koha, e pakryer, veta e III, njejës)

Në fjalinë e fundit një emër në funksionin e kundrinorit të zhdrejtë me parafjalë (shembulli c2), mund fare mirë të jetë një alternativë për xherundin e fjalisë gjegjëse në anglishte.

5.Fjalia kryesore dhe ajo e nënrenditur kanë një kryefjalë të përbashkët, por ka raste kur ato kanë edhe kryefjalë të ndryshme.

Shembuj [5]

I hate them *gossiping* about our colleagues.

(I urrej kur ata *përgojnë* kolegët tanë.)

Përfundime

Bazuar në analizën e mësipërme të periudhës komplekse me fjali të nënrenditur emërore kundrinore në të dyja gjuhët, e konkretisht në strukturat e tyre, kemi mbërritur në përfundimin se:

* Fjalitë e nënrenditura emërore kundrinore ngajnë me fjalitë gjegjëse të gjuhës shqipe për nga tipet kryesore

ndërtimore, por ndryshojnë prej tyre nga mënyra e realizimit konkret në secilën gjuhë.

* Folja kallëzues e fjalisë kryesore është kriteri, në bazë të të cilit fjalitë e nënrenditura kundrinore klasifikohen në të dyja gjuhët.

* Fjalitë e nënrenditura kundrinore me një formë foljore të pashtjelluar në anglishte përkojnë me një formë foljore të shtjelluar në shqipe.

anglisht	shqip
infinitiv	folje në mënyrën lidhore / dëftore
xherund	folje në mënyrën lidhore / dëftore / emër
shembuj	
to represent	të përfaqësoj (mënyra lidhore, koha e tashme, veta e I, njejës)
waiting	të pres (mënyra lidhore, koha e tashme, veta e I, njejës)

* Fjalitë e nënrenditura kundrinore mund të ketë kryefjalë të njejtë me atë të fjalisë kryesore ose jo si në anglishte dhe në shqipe.

I really want **to represent** this country.

“Ok” March 8.2005 (fq 132)

(Vërtet dua **të përfaqësoj** këtë vend.)

He wants you **to go** and pick her up.

“Angel Face” (fq 21)

(Ai do që **të shkosh ta marrësh ti.**)

(Ai do që **ti të shkosh ta marrësh.**)

Referencat

Literatura shkencore

1. Randolph Quirk, Sidney Greenbaum, Geoffrey Leech, Jan Svartvik, “A Comprehensive Grammar of the English language”, Longman, 1985.
2. Randolph Quirk, Sidney Greenbaum, Geoffrey Leech, Jan Svartvik, “A Grammar of Contemporary English”, Longman, 1985 / 1990.
3. Roderich Jacobs, “English Syntax” Oxford University Press, 1995. University Press” 1992.
4. Rodney Huddleston, John Tayne, Anita Mittwoch, Peter Collins, Peter Peterson, Gregory Words, Betty Bauer, Jeffrey Nunberg, Ted Briscoe, Jeffrey Bullu, “Cambridge Grammar of English Language”, Cambridge University Press, 2003.
5. M.Celiku, M.Domi, S.Floqi, S.Mansaku, R.Përnaska, S.Prifti, M.Totoni, “Gramatika e Gjuhës Shqipe 2, Sintaksa”, Tiranë 2002.
6. Xhevat Lloshi, “Stilistika e gjuhës shqipe”, 1997.

Literatura artistike

1. P.D James, “Death in holy Orders”, (roman), Shtëpia botuese “Faber and faber”, 2001.
2. Ernest Hemingway “A Farewell to Arms”, 1995, (roman). “Ok” nr.459, 8 Mars 2005, (revistë).
3. “Angel Face”, 2002, (Film).

Vol I, Nr.2, 2012.

ISSN 1857-8179 (Paper) ISSN 1857-8187 (Online)